

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN- Departamenti i Krimeve të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues Agim Ademi, anëtarët e trupit gjykues Ramiz Azizi dhe Islam Thaçi, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarit T.M., nga ..., rr. " ... " pa nr., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat Sh.Xh., nga ..., për shkak të dy veprave penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par.1. nën par.1.1. të KPRK-ës, dhe veprës penale mbajtja në pronësi, posedim ose shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 374 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I.nr. 125/2017, e datës 09.06.2017 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor e publik më datën 25.09.2017, me datë 27.09.2017 bie dhe në prezence të palëve publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari T.M., nga i ati R., dhe nëna H., e lindur R., i lindur ..., në f. ...Komuna e ... tani jeton në Viti rr." ... " pa nr., i martuar, baba i 9, fëmijëve, aktualisht i pa punësuar, ka të kryer shkollën fillore, i gjendjes së varfër ekonomike, Shqiptar Shtetas i R. së Kosovës.

Ë S H T Ë F A J T O R

I.

Se me datë 04.06.2017 në rrugën " ... " në ... pas një mosmarrëveshje për çështje pronësore që ka pasur me tani të dëmtuarin S.M. (vllaun e tij) të njëjtin e ka goditur me një tërfurk (mjet ky i përshtatëshëm për shkaktimin e lëndimit të rëndë trupor) dhe atë në krahun e majtë në kokë dhe pas veshit të majtë, me ç'rast të njëjtit i shkakton lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohëshme për shëndetin. Po ashtu me këtë rast i akuzuari me tërfurk ka goditur

edhe tani të dëmtuarin F.M.M. dhe atë në pjesën e sipërme të dorës së majtë, i cili në ato çaste kishte hyrë për ta ndarë të akuzuarin dhe me këtë rast të njëjtit i kishte shkaktuar lëndime të lehta trupor me pasoja të përkohëshme për shëndetin.

Me çka ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 188 par.2. lidhur me par.1. e nën par.1.1. të KPRK-ës.

II.

Se i njëjti deri me datë 05.06.2017 ka mbajtur në pronësi dhe posedim pushkën e gjuetisë të llojit pumparicë një tytëshe e markës “Bereta” prodhim italian të kalibrit 12 GA me nr. serik ... pa leje valide.

Me çka ka kryer vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-ës.

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 7, 17, 21,45, 46, 69, 73, 83, 114 të KPRK-ës, dhe neneve 233, 365, 367 par. 1, pika 1.2, dhe 453 të KPPRK-ës.

E G J Y K O N

Të akuzuarin T.M., për veprën penale sipas dispozitivit I. të këtij aktgjykimi me dënim burgu në kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, të cilin dënim i njëjti do ta mbaj në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Për veprën penale si në dispozitivin II të aktgjykimit me dënim gjobe në shumë prej 300 euro, të cilin dënim me gjobë do ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi me gjobë do ti zëvendësohet me dënim burgu duke ju llogaritur nga 20 euro për një ditë burgimi.

Në dënimin e shqiptuar me burgim të njëjtit do ti llogaritet edhe koha e kaluar nën masën e arrestit shtëpiak nga data 05.06.2017 e deri me datë 27.09.2017.

Të akuzuarit T.M. i shqiptohet edhe dënimi plotësues, konfiskimi i mjetit – tërfurkut si dhe pushkës së gjuetisë e markës “Bereta” prodhim italian të kalibrit 12 GA.

Obligohet i akuzuari që ta paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej 30 euro dhe shpenzimet të tjera sipas llogaris përfundimtare të gjykatës.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda ka paraqitur aktakuzën me numër PP.I.nr.125/2017, të datës 09.06.2017, kundër të akuzuarit T.M. nga fshati ..., Komuna ..., për shkak të veprave penale lëndim i lehtë trupo nga neni 188 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të KPRK-së dhe mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, dhe ka kërkuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet me dënim meritior sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, Shaban Spahiu, në fjalën përfundimtare deklaroi se: mbetem në tërësi pran aktit akuzues dhe më pas shtoi se nuk do të ndalem të elaboroj dispozitivin II të aktakuzës pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1. të KPRK-ës ndërsa sa i përket veprës penale lëndim i lehtë trupor konsideron se si gjatë fazës së hetimeve ashtu edhe gjatë shqyrtimit të provave në shqyrtim gjyqësor është vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të qartë gjendja faktike. Po ashtu nga dëshmitarët S.M. dhe F.M. është vërtetuar fakti se i akuzuari me datën kritike ka sulmuar me tërfurk të dëmtuarin S. dhe më pastaj me intervenimin për ti ndarë në fund goditet edhe i dëmtuari F. . Se i akuzuari e ka sulmuar me mjet të fortë të dëmtuarin është vërtetuar edhe nga konstatimi i mjekut lidhur me lëndimet trupore të dëmtuarve S. dhe F.M. ku i njëjti konstaton se lëndimi ka ardhur si pasojë e veprimi mekanik të mjetit të fortë mprehtës. Andaj edhe në bazë të lartcekurave kërkoj që të njëjtit të i shqiptohet një dënim meritior sipas ligjit.

I dëmtuari S.M., ka deklaruar se i bashkëngjitem ndjekjes penale ndaj të pandehurit ndërsa nuk ushtron kërkesë pasurore juridike, deri sa në cilësi të dëshmitarit shtoi se me datë 04.06.2017, rreth orës 10,00 kam shkuar tek xhaxhai im I.M., ashtu që për të shkuar më është dashur të kaloj rrugës për skaj të shtëpisë së T. dhe me atë rast jam takuar me të njëjtin i cili ishte duke shkuar në drejtim të Me tu kthyer nga shtëpia e xhaxhait për në shtëpinë time T. kishte një tërfurk me ca bari të njom e të cilin e kam parë nga një distancë prej 10 metrave e i

cili ka vrapuar në drejtim timin. Duke e parë ngjarjen kushërini im F. ka vrapuar dhe ka hyrë në mes nesh, por që nuk ka arritur ta ndali T. ashtu që T. më ka goditur me pjesën e metaltë të tërfurkut në krahun e majtë edhe atë dy herë dhe një herë në pjesën e bërrylit dhe një herë në pjesën e sipërme ë dorës së majtë. Unë më pas kam reaguuar për tu mbrojtur dhe F. duke e penguar T. edhe ai është goditur nga T., por që më pas T. e ka larguar F. e unë kam shkuar në shtëpinë time dhe e kam njoftuar policin për rastin. E gjithë ngjarja ka zgjatur 2-3 minuta dhe si pasojë e goditjeve unë kam pasur gjakosje në krah ndërsa T. nuk ka pasur lëndime ngase unë nuk e kam goditur. Me T. raportet nuk i kemi të mira për shkak të çështjeve pronësore dhe me të njëjtin nuk flasim qe dy vite e gjysmë.

I dëmtuari F.M. në deklaratën e dhënë në prokurori me datë 07.06.2017, ka deklarua se nuk i bashkohet ndjekjes penale ndaj të akuzuarit dhe nuk ushtron kërkesë pasuroro – juridike, ndërsa ka shtuar se lidhur me ngjarjen që ka ndodhur me datë 04.06.2017, në ... afër shtëpisë time, deri sa unë isha në terasën e shtëpisë time kam parë S.M. duke kaluar rrugës afër shtëpisë së T. e po ashtu kam pa edhe T. i cili ishte me një tërfurk të hekurit në dorë e i cili është nisur drejtë S. dhe përnjëherë e ka goditur S. në krah dhe duar. Unë kam vrapuar për ti ndarë dhe kam hyrë në mes të tyre duke e fshehur S. prapa meje që të mos e godas T.. T. ka bërë përpjekje për të vazhduar ta godas S., e duke dashur përsëri ta godas më ka goditur mua me bishtin e tërfurkut në dorën e djathtë ashtu që unë më pas kam arritur të ia marrë tërfurkun nga dora dhe të njëjtin tërfurk e kam gjuajtur prapa shtëpisë time. Me atë rast T. është ndalur nga sulmi i mëtejme dhe secili kemi shkuar në shtëpitë tona. Pra siç thash edhe më lartë ngjarjen e kam vërejtur mirë dhe fillimisht T. e ka sulmuar S. me Terfurk ndërsa S. duke u mbrojtur ka mundur ta ketë goditur, por unë nuk e kam vërejtur. Lidhur me rastin më ka kontaktuar policia për të dhënë një deklaratë e më pas Policia mua dhe S. nga kanë dërguar për ndihmë mjekësore në Qendrën e Mjekësisë Familjare në Viti e nga aty për në Spitalin Regjional të Gjilanit, duke na i lidhur plagët në duar.

I akuzuari T.M., në mbrojtjen e tij deklaroi se ditën kritike kam qenë duke e kositur barin në oborrin tim dhe me atë raste ka ardhur S. rrugës afër aty ku unë isha duke kositur në stom të rrugës. Unë jam nisur në drejtim të S. dhe S. më ka goditur me grushta por nuk e di se cili e kemi goditur e pari. Si pasojë e goditjes me grushta me siguri që të njëjtin e kam lënduar porse aty në të dy anët ka rrethoja teli. Fillimisht e kam goditur në pjesën e kokës e lëndime ka marr edhe në krah por në cilin krah nuk më kujtohet. Deri sa ne ishim duke u kacafytur ka arritur kushërini i jonë F. dhe i njëjti vetëm na ka ndarë pasi që të njëjtin e kemi djalë të axhës. Në këtë ngjarje edhe unë kam qenë i lënduar pasi që kam pasur gërvishnje në pjesën e ballit porse nuk kam shkuar te mjeku. Sa i përket mjetit (tërfurkut) për të cilin po flitet i njëjti është gjetur afër shtëpisë së F. dhe është fotografuar nga policia pas dy-tri ditëve. Sa i përket F. i cili ka ardhur pasi që ka filluar kacafytja, të njëjtin unë nuk e di që e kam goditur, por nuk e përjashtoi mundësin të jetë lënduar ngase i njëjti duke na ndarë mund të jetë lënduar pasi që aty afër

është një tel i një fqinji dhe nuk është e vërtetë që F. të ma ketë marr tërfurkun nga dora, ngase tërfurk unë nuk kam fare në shtëpi, por që policia me qëllim të më ngarkoi mua e kanë sjellë tërfurkun. Më vjen keq për ngjarjen që ka ndodhur pasi që të dëmtuarin e kam vëlla dhe i propozoi trupit gjykues që në rastin konkret të vendos në mënyrë të drejtë.

Mbrojtësi i të akuzuarit T.M., avokat Sh.Xh., në fjalën përfundimtare deklaroi se: i mbrojturi i im pjesërisht e pranon kryerjen e veprës penale nën pikën I të dispozitivit të akuzës dhe në bazë të mbrojtjes së tij rezulton se i njëjti nuk e ka përdorur mjetin përkatësisht tërfurkun siç ceket në aktakuzë. Se nuk është përdorur tërfurku është konstatuar edhe nga konstatimi i mjekut përkatësisht ekspertit i cili në mendimin e tij mes tjerash ka thënë se lëndimi është kryer me mjet të fortë mbrehës (jo të mbrehtë) dhe siç e dimë nga praktika tërfurku është mjet i mbrehtë. Andaj duke marrë parasysh se i njëjti nuk ka raporte të mira familjare me të dëmtuarin S.M. të cilin e ka vëlla, moshën e tij dhe se i njëjti është person familjar, baba i 9 fëmijëve, i propozoj gjykatës që të akuzuarit ti shqiptohet një dënim më të butë me të cilin do të arrihet qëllimi i dënimit.

Trupi gjykues shtjelloi shkresat e lëndës, edhe atë formularin lidhur me konfiskimin e armës së zjarrit, shikimin e foto dokumentacionit dhe atë 8 fotove nga vendi i ngjarjes, mendimi dhe konstatimi i ekspertit mjeko ligjor të datës 06.07.2017, lidhur me natyrën e lëndimeve të dëmtuarve S. dhe F.M. .

Nga provat e shtjelluara në shqyrtimin gjyqësor dhe vlerësimin e tyre veç e veç si dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8. dhe 361, të KPPRK-ës gjykata konstatoi këtë gjendje faktike: se ditën kritike me datë 04.06.2017, në ... në rrugën “ ... ” deri sa i dëmtuari S.M. ishte duke kaluar rrugës pranë shtëpisë së të akuzuarit T.M., i akuzuari ishte me një tërfurk në dorë, për shkak të raporteve të çrregulluara me të dëmtuarin, (vëllain e tij) dhe një ngatërrese të më hershme për shkaqe pronësore, nisat në drejtim të dëmtuarit dhe me tërfurk të metaltë e godet në pjesën e parakrahut të majtë si dhe në pjesën e kokës dhe duke e pa ngjarjen i dëmtuari F. nga shtëpia e tij vrapon për të i ndarë duke ju hyrë në mes por që i akuzuari T. duke insistua që përsëri ta godas të dëmtuarin S. me atë rast e godet me tërfurk edhe të dëmtuarin F. në parakrahun e dorës së majtë. Me atë rast i dëmtuari F. ka arritur që të akuzuarit T. të ia marrë tërfurkun nga dora duke e hedhur pranë shtëpisë së tij dhe më pas ka përfunduar e tëra dhe të njëjtit kanë shkuar nëpër shtëpitë e tyre. Si pasojë e lëndimeve të mara të dëmtuarit S. dhe F.M. janë dërguar për trajtim mjekësor në QMF në Viti e më pastaj edhe në Spitalin Regjional të Gjilanit.

Me rastin e konstatimit të gjendjes faktike ju fal besimi provave materiale edhe atë mendimit dhe konstatimit mjeko ligjor të datës 07.06.2017 lidhur me natyrën e lëndimeve të pësuar, foto dokumentacionit nga vendi i ngjarjes lidhur me faktin se aty është gjetur edhe

mjeti – tërfurku. Po ashtu ju fal besimi edhe dëshmime të dëmtuarve të dhëna në cilësinë e dëshmitarëve S. dhe F.M. të cilët deklarojnë në mënyrë bindëse se në rastin konkret i akuzuari e ka përdorur mjetin – tërfurkun duke i goditur të njëjtin. Pjesërisht ju fal besimi edhe mbrojtjes së të akzuarit lidhur me kohën dhe vendin e kryerjes së veprës penale, por nuk ju fal besimi pjesës së deklaratës së tij kur deklaron se nuk e ka përdorur tërfurkun dhe nuk ka pasur fare tërfurk nga se kjo pjesë e deklaratës së tij bie në kundërshtim me provat materiale të theksuara më lartë por edhe me dëshmitë e të dëmtuarve, dhe se deklarimi i tillë duke e mohuar faktin ta ketë përdorur mjeti (tërfurkun) është vetëm përpjekje të ju shmangur përgjegjësisë penale.

Sa i përket veprës penale nën dispozitivin II të aktgjykimit të veprës penale mbajtja në pronësi, ose posedim të paautorizuar të armës nga neni 374 par.1. të KPRK-ës, i akuzuari T.M. e ka pranuar fajësinë dhe këtë pranim të fajësisë gjykata e ka aprovuar ngase një pranim i tillë i fajësisë ishte bindës dhe i bërë në prezencë të mbrojtësit të tij si dhe ishte edhe në harmoni me provat materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës edhe atë foto dokumentacioni ku shihet arma e sekuestruar si dhe vërtetim prone e datës 04.06.2017, me të cilën është vërtetuar se i akuzuari deri me datë 05.06.2017, ka mbajtur në pronësi dhe posedim pa autorizim pushkën e gjuetisë të llojit “Pomparic” njëtytëshe të markës “Bereta” prodhim italian të kalibrit 12 GA me nr. serik ... pa leje valide.

Me rastin e caktimit të llojit dhe të lartësisë së dënimit për të akzuarin, Gjykata pati parasysh rrethanat të parapara me nenin 73 të KPK-ës, dhe si rrethanë lehtësuese gjeti se i akuzuari e ka pranuar fajësinë sa i përket veprës penale nën dispozitivin II të aktgjykimit, ndërsa sa i përket veprës penale nën I. të aktgjykimit ka shprehur keqardhje për rastin që ka ndodhur, se është njeri familjar, se është baba i 9.fëmijëve, pati sjellje të mira në gjykatë si dhe gjendjen e rëndë ekonomike. Ndërsa si rrethanë rënduese pati parasysh shkallën e rrezikshmërisë shoqërore duke qenë se vepra penale është kryer ndaj familjarëve të tij (vëllaut dhe kushërit), motivi për kryerjen e kësaj vepre penale pasi që vepra penale është kryer me motiv të hakmarrjes për shkak të problemeve të pa zgjidhura si dhe mjetit të përdorur. Në prezencë të rrethanave të tilla (lehtësuese dhe rënduese) të akzuarit ju shqiptua dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me bindje se edhe me një dënim të tillë do të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenin 41 të KPRK-së, në mënyrë që i akuzuari në të ardhmen mos të kryej vepra tjera penale por edhe të parandalojë personat e tjerë të mos kryejnë vepra penale.

Vendimi mbi dënimin plotësues, konfiskimi i mjetit- tërfurkut si dhe pushkës së gjuetisë të markës “Bereta”, prodhim italian e kalibrit 12 GA, bazuar në nenin 69 par.1 dhe 374 par. 3 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale është i bazuar në nenin 453 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr. 133/17 Me datë. 27.09.2017**

Sekretarja Juridike
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti i Krimeve të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.